



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

RAPORT

PËR REZULTATET E KONSULTIMIT PUBLIK, TË PROJEKTLIGJIT

“Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë për naftën bruto dhe nënproduktet e saj”

1. Titulli i projekt aktit

Projektligji “Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë për naftën bruto dhe nënproduktet e saj”.

Ky projektligj përcakton detyrimet për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë për naftën bruto dhe nënproduktet e saj për të siguruar një nivel të lartë të sigurisë së furnizimit me naftë bruto dhe nënprodukte të saj në Republikën e Shqipërisë.

Projektligji rregullon procedurat e nevojshme për përdorimin e rezervave të sigurisë në rast të reduktimit të papritur deri në mungesë të furnizimit të tregut me nënprodukte të naftës bruto dhe do të jetë Këshilli i Ministrave, i cili do të marrë vendim në përputhje me planin kombëtar të reagimit për mënyrën e përdorimit të rezervës së sigurisë.

Për realizimin e këtyre detyrimeve në projektligj është parashikuar krijimi i Autoritetit përgjegjës për mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë për naftën bruto dhe nënprodukte të saj.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Projektligji iu nënshtrua procesit të konsultimit publik nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, për një periudhë prej 20 ditë pune nga data e shpalljes së njoftimit, në bazuar në ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik.

Publikimi u bë në datë 6.10.2025 dhe nëpërmjet një njoftimi të publikuar online në RENJKP, të gjitha palët e interesuara:

(1) organet publike;

2) shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit;

3) personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë,

si dhe personat juridikë të huaj, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, ishin të ftuar për të paraqitur komentet dhe rekomandimet e tyre për projektaktin, në adresën e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik: vilma.davidhi@infrastruktura.gov.al.

Data e mbylljes së procesit të konsultimit ishte 3.11.2025.

Projektligji si dhe relacioni përkatës u publikuan në linkun:

[Projektligji “Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë për naftën bruto dhe nënproduktet e saj”](#), në rubrikën “qytetar” dhe rubrikën “ekspert” të RENJKP.

3. Metodatat e konsultimit

Listoni të gjitha metodatat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguronit informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitetet nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Projektligji “Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë për naftën bruto dhe nënproduktet e saj”, u konsultua nëpërmjet metodave të mëposhtme:

1. Nëpërmjet publikimit në Regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike nga data 6.10.2025 deri në 3.11.2025;
2. Nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në datë 6.10.2025 deri në 3.11.2025, të projektligjit dhe paketës shoqëruese;

3. Njëpërmjet postës elektronike të koordinatorit për njoftim dhe konsultim publik: vilma.davidhi@infrastruktura.gov.al.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Palët e interesuara, të cilat morën pjesë në hartimin e këtij projektakti janë Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në Vienë dhe ministritë e linjës.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuar

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Projektligji “Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë për naftën bruto dhe nënproduktet e saj”, ka pasur 351 lexime nga qytetarët dhe 385 ekspertët, gjatë publikimit në regjistrin elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik (RENJKP), ndërsa nuk ka patur komente në RENJKP si dhe njëpërmjet postës elektronike.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
---	--	--	---	-------------